



Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo
Institucioni i Ombudspersonit • Ombudsperson Institucija • Ombudsperson Institution

6 prill 2009

z. Beqir Mernica
Adresa: rr. Majdani p.n
Mitrovicë

Ankesa nr.485/08

NJOFTIM

I nderuari z. Mernica

Ombudspersoni e ka shqyrtuar ankesën e paraqitur më 26 nëntor 2008 dhe të regjistruar më të njëjtën datë nga e cila kuptohet se parashtruesi i saj ankohet lidhur me zbatimin e marrëveshjes për renovimin e shtëpisë së ankuesit.


Ombudspersoni ka mandat në bazë të rregullorës 2006/06 të UNMIK-ut mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, për të hetuar pretendimet ankimore për shkeljet të drejtave të njeriut nga ana e autoriteteve publike të Republikës së Kosovës.

Meqenëse, ankesa e tanishme ka të bëjë në fondacionin “ Behgjet Pacolli” është fondacion privat, që Ombudspersoni ka provuar të ofroj shërbime të mira në këtë çështje dhe lidhur në veprimet e ndërmarra ju njoftojmë si në vijim:

Nga Fondacioni “Behgjet Pacolli” – në referencën nr.58 të datës 23 mars 2009 ceket se pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje kanë filluar përgatitjet për fillimin e punëve në shtëpinë e z. Mernica, por terreni nuk ishte i sigurt, nuk u është ofruar kurrëfarë garancie që punët e renovimit mund të fillojnë pa u penguar .

Po ashtu, në informatë ceket se Z. Behgjet Pacolli ka qenë vet personalisht dy herë në Lagje të boshnjakëve në pjesën veriore në Mitrovicë, me përcjellje të Policisë së Kosovës për të parë për së afërmi gjendjen dhe sigurinë që ofronte kjo lagje për fillimin e punëve për renovim, por edhe ai është bind se është e pamundur të fillohet. Përderisa, nuk ofrohet një siguri e plotë, është pamundur të fillohen punët e renovimit të shtëpisë sipas marrëveshjes, fondacioni “Behgjet Pacolli” ndihmon dhe vazhdon të ndihmojë në renovimin e shtëpive

Dëshmitë e paraqitura më lartë nuk tregojnë se ekziston ndonë shkelje e të drejtave të njeriut .


Sinderisht i juaji

Hilmi Jashari
Ushtues i Detyrës së Ombuspersonit